

2025

RAPORT VJETOR

Përgatitur nga:

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

www.akd.gov.al



RAPORTI VJETOR 2025

RAPORTIMI I AKTIVITETEVE TË
ZHVILLUARA DHE PASQYRËS FINANCIARE

2025





Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	5
OBJEKTIVAT E ARRITURA GJATË VITIT 2025	5
1. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS	6
1.1.ORGANET DREJTUESE	6
1.1.1. DREJTORI EKZEKUTIV	6
1.2.STRUKTURA ADMINISTRATIVE	6
1.2.1. Drejtoria e Diasporës	6
1.2.2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse	7
1.2.3. Njësia e Menaxhimit të Projekteve	7
2. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE	8
2.1. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025	8
2.2. Ligji 16/2018 “Për Diasporën	9
3. AKTIVITETET E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS	10
3.1.AKTIVITETE DHE PROJEKTE TE INICIUARA APO REALIZUARA NGA AGJENCIA PERGJATE VITIT 2025	10
3.1.1. Dita e Diasporës 18 dhjetor 2025 - Projekti kulturor: “Trajnimi i valltarëve nga diaspora shqiptare në Ukrainë”	10
3.1.2. Aktivitet në Universitetin Westminster, Londër, datë 26 prill 2025	12
3.1.3. Aktivitet Diaspora Shqiptare–Partneritet në Ndërkombëtarizim -Java Globale e Sipërmarrjes	13
3.1.4. Aktivitet “Diaspora Flet” Köln, Gjermani, në datat 07-09 nëntor 2025	14
3.1.5. Projekte të zhvilluara gjatë vitit 2025	15
3.1.5.1. Projekti Shkolla Verore “Jam shqiptar”	15
3.1.5.2. Projekti “Turi “ Shqipëria përmes syve të të rinjve arbëreshë”	16
3.1.5.3. Projekti “Trajnimi i të rinjve valltarë nga diaspora shqiptare në Zvicër”	16
3.1.5.4. Projekt kulturor: Shfaqja e dokumentarit “Një princeshë evropiane” dedikuar jetës së Donika Kastriotit	17
3.1.6. Aktiviteti “Gjon Mili Jazz& Blues Festival” 8 , 9 dhe 10 korrik 2025 në Tiranë	17
3.1.7. Projekt në kuadër të ditës së Alfabetit	18
3.1.8. Bashkëpunim në kuadër të CulturAlb-Ditët Shqiptare në Botë- Athinë në datat 14-17 nëntor 2025	18



3.1.8.1.	Aktivitet me Shoqatën “Tirona – Lidhja e Shqiptarëve në Greqi”	18
3.1.8.2.	Takime me shoqatat shqiptare në Athinë.....	20
3.1.8.3.	Bashkëpunim në kuadër të CulturAlb-Ditët Shqiptare në Botë -Poloni datë 25 nëntor- 5 dhjetor 2025	20
3.1.9.	Forumi i Ekspertëve Rajonalë të Diasporës në Prishtinë, datë 12 dhjetor 2025	22
3.1.10.	Kuvendi III – i Arbëreshëve	22
4.	DATAVAZA E STUDENTËVE	23
5.	MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI	23
6.	RAPORTIM DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE.....	24
6.1.	ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2025	24
6.2.	Realizimi	25
	TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)	25
6.2.1.	Për fondin e pagave dhe sigurimeve (llogaria ekonomike 600,601)	26
6.2.2.	Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)	27
6.2.3.	Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231).....	27
6.2.4.	Fond i veçantë (llogaria ekonomike 606)	27
6.3.	DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (FUNKSIONIMI).....	28
6.3.1.	Financa.....	28
6.3.2.	Burime Njerëzore.....	28
6.3.3.	Protokolli	30
6.3.4.	Magazina.....	30
6.3.5.	Prokurime.....	30
	SFIDA NË TË ARDHMEN.....	31
	PROGRAMI 2026	31
	OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN NËPËRMJET PROGRAMIT..	31
	TARGET GRUPET	32
	IMPAKTI.....	32
	PRITSHMËRITË	32
	METODOLOGJIA	33
	PËRMBYLLJE	34



HYRJE

Agjencia Kombëtare e Diasporës është ndër institucionet kryesore shtetërore përgjegjëse për zbatimin e politikës së qeverisë shqiptare në marrëdhëniet e diasporës shqiptare me vendin e origjinës. Ajo ka për mision nxitjen dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me komunitetet shqiptare në diasporë, me qëllim zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në zhvillimin ekonomik, politik, social dhe kulturor të Shqipërisë.

Raporti Vjetor 2025 është një përmbledhje e funksioneve dhe aktiviteteve të realizuara nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, kundrejt objektivave kryesorë vjetorë dhe atyre strategjikë. Agjencia Kombëtare e Diasporës gjatë vitit 2025 ka vepruar në përputhje me drejtimin strategjik dhe në një frymë me politikat qeveritare në fushën e diasporës. Raporti shërben për të informuar institucionet përgjegjëse dhe publikun rreth veprimtarisë të Agjencisë gjatë vitit 2025. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës; struktura e institucionit, veprimtaria e institucionit gjatë vitit 2025, aktivitetet institucionale, aktet ligjore bazë për veprimtarinë e AKD si dhe analiza financiare për vitin 2025.

OBJEKTIVAT E ARRITURA GJATË VITIT 2025

- Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me diasporën, bashkëveprimi i ngushtë me organizatat vepruese në diasporë;
- Ruajtja e identitetit gjuhësor e kulturor si dhe fuqizimi i lidhjeve me komunitetet shqiptare në botë;
- Nxitja e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet investimeve nga diaspora;
- Ndërgjegjësimi dhe lehtësimi i përfshirjes së diasporës në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;
- Pasurimi i bazës së të dhënave të diasporës shqiptare;
- Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
- Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.





1. AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës është person juridik publik buxhetor, në varësinë e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme e cila funksionon bazuar në:

- **Ligjin nr.16/2018 “Për Diasporën”, i ndryshuar (neni 22/1);**
- **Vendimin nr.120 datë 6.3.2024 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.**

1.1.ORGANET DREJTUESE

Në përputhje me pikën 3 të VKM nr.120 datë 6.3.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Diasporën”, Agjencia drejtohet nga titullari i Agjencisë, i cili organizon e drejton veprimtarinë e saj, përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet para ministrit.

1.1.1. DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Diasporës është autoriteti më i lartë ekzekutiv i saj. Ai është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë. Në vitin 2025, kjo detyrë ushtrohet nga znj. Ermonela Xhafa, e cila posedon statusin administrativ, Drejtues i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND).

Drejtori Ekzekutiv raporton periodikisht, për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Diasporës pranë Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

1.2. STRUKTURA ADMINISTRATIVE

Struktura administrative e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” dhe përbëhet nga: Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori i Projekteve.

1.2.1. Drejtoria e Diasporës

Drejtorja e Diasporës është përgjegjëse:



- Për koordinimin me qëllim vëzhgimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit të saj;
- Për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e detyrimeve të lidhura me qëllimet dhe aktivitetin e Agjencisë.

1.2.2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse:


- Për administrimin e buxhetit të miratuar dhe veprimtarinë financiare të Agjencisë;
- Për përgatitjen e projekt-buxhetit dhe për administrimin e çdo çështjeje që lidhet me hartimin e planit financiar buxhetor afatmesëm e vjetor me qëllim arritjen e objektivave të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

1.2.3. Njësia e Menaxhimit të Projekteve

Njësia e Menaxhimit të Projekteve është përgjegjëse:

- Për planifikimin, drejtimin dhe zbatimin e projekteve në përputhje me misionin e institucionit dhe në nxitje të sipërmarrjes së Diasporës për zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor.
- Koordinon me donatorët e projekteve në realizimin e objektivave dhe veprimtarisë të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për Zhvillimin e Diasporës:

STRUKURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS





2. USHTRIMI I DETYRAVE FUNKSIONALE

2.1.Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, luan një rol thelbësor koordinues në procesin e vlerësimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 ashtu si dhe në hartimin e Strategjisë së re 2026–2030, në bashkëpunim me organizatat partnere GIZ dhe IOM.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, bazuar në kreun III, pika 2/c të VKM nr.120 datë 6.3.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës” ka një rol specifik, “ndjek zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës”. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021–2025 është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.585 datë 22.07.2020 dhe viti 2025 shënon vitin e fundit të zbatimit të saj. (Strategjia përbëhet nga 72 masa në total dhe 68 indikatorë). Vërehet se, për vitin 2025 nuk ka masa të reja që kërkojnë zbatim, përveç atyre të parashikuara në vitet parardhëse.

Në kuadër të procesit të vlerësimit të Strategjisë aktualisht në zbatim, gjatë vitit 2025, është përfutur një analizë paraprake nga institucionet zbatuese të masave konkrete të Planit të Veprimit (mbështetur në shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të MEPJ nr. 7150 prot., datë 20.05.2025) të cilat janë pasqyruar në një Raport përmbledhës. Mbështetur në Urdhërin e Kryeministrit nr. 30, datë 17. 2. 2021 “Për përcaktimin e grupit të koordinatorëve, për zbatimin e planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025” institucionet që kanë përcjellë kontribut janë: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ministria e drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mrojtjes Sociale, Ministria e Financave, AKSHI, Banka e Shqipërisë, Akademia e Shkencave, Instat, si dhe Këshilli Koordinues i Diasporës.

Njëkohësisht, Agjencia Kombëtare e Diasporës në partneritet me organizatën GIZ Albania kanë bashkëpunuar në hartimin e një raporti vlerësimi të Strategjisë Kombëtare



të Diasporës 2021–2025 dhe planit të saj të veprimit, gjetjet e së cilës u prezantuan në Workshopin e zhvilluar në Tiranë, në datë 27 tetor 2025. Ky workshop shërbeu si një platformë diskutimi për prezantimin e arritjeve dhe sfidave të konstatuara gjatë zbatimit të Strategjisë.

Puna e nisur gjatë vitit 2025, me fokus rishikimin e Strategjisë aktuale dhe hartimin e Strategjisë së re për Diasporën 2026-2030 do të vijojë gjatë vitit pasardhës.

Dokumenti final i Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2026-2030 pritet të paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave, nga Grupi Ndërinstitucional i Punës që do të ngrihet për këtë qëllim, nëpërmjet Ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda muajit qershor 2026.

2.2.Ligji 16/2018 “Për Diasporën

Agjencia Kombëtare e Diasporës nën kryesimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme u bë pjesë dhe luajti një rol të rëndësishëm në kuadër të procesit të ndryshimeve ligjore në Ligjin 16/2018 “Për Diasporën”. Agjencia Kombëtare e Diasporës ishte e pranishme në dëgjesat e Komisioneve Parlamentare të cilat i paraprinë miratimit të ndryshimeve ligjore në seancë.

Procesi përfundoi me miratimin në Ditën Kombëtare të Diasporës, datë 18 dhjetor 2025, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të Ligjit nr. 93/2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.16/2018 “Për Diasporën”, i ndryshuar, ligj i cili ridimensionon angazhimin e institucioneve publike për vendosjen e diasporës në zemër të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe shoqëror të vendit dhe synon të rregullojë qartë marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe ndërveprimit midis autoriteteve shtetërore dhe diasporës shqiptare, duke garantuar ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor dhe arsimor të saj.

Risi paraqet neni 22/1 i ligjit që përcakton se “Agjencia Kombëtare e Diasporës krijohet si institucion varësie për të kryer funksione të përcaktuara brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore të ministrit përgjegjës për diasporën. Krijimi,



misioni, funksionet dhe organizimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.”.

Në bashkërendim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka propozuar gjithashtu, disa rregullime nën ligjore në zbatim të këtij ligji, me qëllim plotësimin e kornizës ligjore me fokus diasporën.

3. AKTIVITETET E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka hartuar programin vjetor duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e drejtpërdrejta të pjesëtarëve të diasporës shqiptare si dhe kërkesave që rrjedhin nga zbatimi i “Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025”.

TARGET GRUPET

Target grupet fokus i planit të veprimtarive të Agjencisë për vitin 2025:

1. Komunitetet e hershme dhe të reja shqiptare në diasporë;
2. Komuniteti i grave shqiptare në biznes;
3. Shoqatat e kërkuesve shkencorë dhe akademike (brain gain vs brain drain);
4. Rrjetëzimi i profesionistëve në diasporë;
5. Shoqatat, organizatat, grupet lokale dhe rrjetet e krijuara nga diaspora shqiptare;
6. Forumet e të rinjve të lindur/rritur në diasporë.

3.1.AKTIVITETE DHE PROJEKTE TË INICIUARA APO REALIZUARA NGA AGJENCIA PËRGJATË VITIT 2025

3.1.1. Dita e Diasporës 18 dhjetor 2025 - Projekti kulturor: “Trajnimi i valltarëve nga diaspora shqiptare në Ukrainë”

Në kuadër të projektit “Trajnimi i valltarëve nga diaspora shqiptare” një grup nga diaspora e vjetër shqiptare në Ukrainë, vizituan Shqipërinë në datat 13-20 dhjetor 2025 të cilët u bënë pjesë e një programi të larmishëm kulturor dhe artistik që përfshin vizita



kulturore, trajnime profesionale dhe aktivitete artistike. Ata janë pjesë e Ansamblit të vallëzimit amator “Iliria” dhe Ansamblit të këngës dhe vallëzimit shqiptar “Kolorit”.

Ky projekt u realizua falë përkushtimit të Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, punës së profesionistëve të Ansamblit Popullor të Këngëve dhe Valleve, si edhe me mbështetjen e Ambasadës së Ukrainës në Tiranë.

Pjesëmarrësit nga ky komunitet i veçantë, shtetas ukrainas me prejardhje shqiptare, të lindur dhe rritur larg atdheut, por që kurrë nuk i kanë harruar rrënjët e tyre, dëshmuar se identiteti shqiptar ruhet, kultivohet dhe trashëgohet brez pas brezi me një dashuri pa kushte, e cila mbart ndjenjën e fortë të përkatësisë me gjakun e të parëve.

Gjatë qëndrimit të tyre në Shqipëri, grupi artistik nga diaspora shqiptare në Ukrainë patën mundësinë të vizitonin: qytetin antik të Durrësit me atraksionet, Kullën Veneciane dhe Amfiteatrin, monumente të rëndësishme të trashëgimisë historike shqiptare, Qendrën Kulturore të Fëmijëve më pas vijuan me qytetin historik të Krujës, ku u vizitua Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, si një moment i veçantë njohjeje me rrënjët, historinë dhe identitetin kombëtar, Kryeqytetin Tiranë, ku grupi ndoqi trajnimet profesionale me vallet shqiptare nga artistë dhe pedagogë të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit, ndërthurur me vizita në atraksione kulturore si: vizita në qendër të qytetit ku u njohën me Bustin e Gjergj Kastriot Skënderbeu, Kalaja e Toptanëve, Muzeu i Bankës së Shqipërisë, Muzeu i Postave, ambientet e “Albania Night”. Gjithashtu kryen një vizitë studimore në mjediset e Fondacionit “Tradita Popullore” ku grupi artistik nga diaspora ukrainë u njoh nga afër me veshjet kombëtare të punuara me mjeshtëri nga artizanë shqiptarë, të performonte me to dhe të bënin fotografi si një kujtim i bukur dhe mbresëlënës nga vizita e tyre në Shqipëri.

Grupi i artistëve nga diaspora e vjetër shqiptare në Ukrainë, i shoqëruar nga Ambasadori i Republikës së Ukrainës në Shqipëri, SH.T.Z. Volodymyr Shkurov, zhvilloi në datë 16 dhjetor 2025 një vizitë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Grupi u prit nga Drejtoresha Ekzekutive e



Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Znj. Ermonela Xhafa si dhe Drejtoresha e Diplomacisë Ekonomike, Kulturore dhe të Diasporës, Znj. Silvana Leskaj. Biseda u fokusua në forcimin e lidhjeve mes diasporës shqiptare në Ukrainë dhe institucioneve shqiptare, në rolin e rëndësishëm që luan komuniteti shqiptar në Ukrainë në ruajtjen e identitetit, gjuhës dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, si dhe në rëndësinë e bashkëpunimeve të vazhdueshme në fushën e kulturës dhe artit. Palët vlerësuan përkushtimin e këtij komuniteti për ruajtjen e gjuhës, traditave dhe zakoneve të të parëve, duke e konsideruar këtë si një shembull të gjallë të trashëgimisë kulturore që mbijeton përtej kufijve.

Gjithashtu, grupi artistik vizitoi mjediset e RTSH-së ku u bënë pjesë e emisionit televiziv “Në kohë reale” e cila padyshim ngjalli emocione dhe interes jo vetëm për pjesëmarrësit por edhe për publikun e gjerë.

Projekti kulturor kulmoi me një shfaqje artistike titulluar “Kërcim pa Kufij” e dhënë në Teatrin e Operas dhe Baletit me rastin e Ditës Kombëtare të Diasporës. Diaspora shqiptare nga Ukraina dhe Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore i dhuruan publikut shqiptar emocione të rralla, të cilat përçuan tek ai vlerat e çmuara historike e kulturore, të ruajtura ndër shekuj nga komuniteti i hershëm shqiptar i fshatit Karakurt të Odesës.

3.1.2. Aktivitet në Universitetin Westminster, Londër, datë 26 prill 2025

Në datë 26 prill 2025, në mjediset e Universitetit Westminster-it në Londër, u zhvillua për herë të parë një aktivitet kushtuar kulturës, artit dhe trashëgimisë shqiptare.

Shoqata e Grave Britaniko-Shqiptare në bashkëpunim me Fondacionin “Tradita Popullore”, Universitetin e Westminster-it dhe Agjencinë Kombëtare e Diasporës, organizuan këtë aktivitet kaq kuptimplotë. Pjesëmarrëse në këtë aktivitet ishte Drejtoresha Ekzekutive, znj. Ermonela Xhafa e cila përfaqësoi denjësisht Agjencinë Kombëtare të Diasporës.



Aktiviteti përfshiu: fjalime përshëndetëse, valle tradicionale, ekspozitë veshjesh autentike, dokumentarë, muzikë tradicionale me çifteli.

Znj. Xhafa gjatë prezantimit, theksoi se, trashëgimia kulturore shqiptare është pasuri e vyer që duhet ruajtur dhe përcjellë brezave. Gjithashtu, vlerësoi rolin e diasporës në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe theksoi rëndësinë e të rinjve shqiptarë jashtë vendit si ambasadorë të denjë të kulturës sonë. Znj. Xhafa theksoi edhe angazhimin e MEPIJ në mbështetje të studentëve shqiptarë jashtë vendit.

Fondacioni “Tradita Popullore”, zhvilloi një prezantim mbi veshjet tradicionale shqiptare përmes slide-ve, videove dhe një ekspozite mbresëlënëse.

3.1.3. Aktivitet Diaspora Shqiptare – Partneritet në Ndërkombëtarizim – Java Globale e Sipërmarrjes.

Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD), në bashkëpunim me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare dhe Agjencinë STARTUP Albania dhe nën kujdesin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, organizoi në datë 19 nëntor 2025, në mjediset e Shtëpisë së Biznesit, Piramida Tiranë, panelin e diskutimeve: “Diaspora Shqiptare – Partneritet në Ndërkombëtarizim.”

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të Javës Globale të Sipërmarrjes dhe kishte për synim të forcojë rolin e diasporës shqiptare si partner strategjik në proceset e ndërkombëtarizimit ekonomik, profesional dhe institucional të Shqipërisë. Diskutimet u fokusuan në mënyrat se si ekspertiza, rrjetet profesionale dhe përvojat ndërkombëtare të diasporës mund të shndërrohen në partneritete të qëndrueshme për bizneset shqiptare, institucionet publike dhe nismat komunitare.

Në qendër të diskutimeve ishin gjithashtu nxitja e inovacionit, transferimi i dijes dhe promovimi i markës “Made by Albanians”, si një qasje e unifikuar për forcimin e identitetit ekonomik e kulturor shqiptar në tregjet globale.



Gjatë punimeve dolën ide për projekte të përbashkëta ndërmjet institucioneve dhe bizneseve të diasporës, si dhe rekomandime për zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe mbështetjen e sipërmarrjeve shqiptare jashtë vendit. U theksua gjithashtu se janë bërë një numër i konsiderueshëm aplikimesh dhe janë fituar disa projekte që mbështesin financiarisht bizneset e diasporës, duke forcuar rolin e tyre si faktor zhvillimi dhe inovacioni.

Aktiviteti u zhvillua në formën e një tryeze pune, ku të pranishmit ndanë përvoja dhe ide konkrete bashkëpunimi. Në panel morën pjesë: përfaqësues të institucioneve shtetërore, përfaqësues të Këshillit Koordinues të Diasporës (KKD), përfaqësues të GIZ, përfaqësues të Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare si dhe sipërmarrës nga Shqipëria dhe jashtë saj, të cilët ndanë përvoja suksesi dhe ide konkrete bashkëpunimi për zhvillimin ekonomik dhe profesional të vendit. Aktiviteti u përshëndet dhe nga Zëvendësministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Blerta Rama, e cila ndau përvojën e saj personale si pjesë e diasporës shqiptare dhe vuri theksin tek rëndësia e talenteve, profesionalizmi dhe potenciali i lartë inovativ që diaspora sjell në zhvillimin ekonomik të vendit.

3.1.4. Aktivitet “Diaspora Flet” Köln, Gjermani, në datat 07– 09 nëntor 2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka qenë e pranishme në konferencën ndërkombëtare “Diaspora Flet” zhvilluar në Köln, Gjermani, në datat 07-09 nëntor 2025, organizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Gjermani dhe GERMIN. Agjencia u përfaqësua nga Drejtori Ekzekutiv znj. Ermonela Xhafa.

Në kuadër të Konferencës “Diaspora Flet” u realizua edhe shpërndarja e librave të gjuhës shqipe për mësuesit që japin mësim në Landin e Nordrhein-Westfalen (NRW), një nga qendrat më aktive të mësimdhënies së shqipes në diasporë.

Ky proces i rëndësishëm u organizua nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Gjermani, me pjesëmarrjen dhe të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Në aktivitet morën pjesë Ambasadorja e Shqipërisë në Gjermani, znj. Adia Sakiqi, dhe Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Ermonela Xhafa, të



cilat theksuan rëndësinë që ka ky proces për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit shqiptar në brezat e rinj të diasporës.

Gjatë takimeve me mësuesit e gjuhës shqipe në NRW, u zhvilluan biseda për forcimin e bashkëpunimit, përmirësimin e materialeve mësimore dhe nevojën për trajnime të posaçme për mësuesit në diasporë.

Ambasada e Shqipërisë në Gjermani po bën një punë të vyer në forcimin e lidhjeve me diasporën dhe në përhapjen e mësimin të gjuhës shqipe për brezat e rinj.

Agjencia Kombëtare e Diasporës vlerëson rolin dhe bashkëpunimin e përfaqësive tona diplomatike me Qendrën e Botimeve për Diasporën, si dhe me shoqatat e mësuesve në diasporë për zhvillimin e këtij procesi dhe mbetet e përkushtuar për të mbështetur çdo nismë që ndihmon ruajtjen e gjuhës, traditës dhe kulturës shqiptare në diasporë.

3.1.5. Projekte të zhvilluara gjatë vitit 2025

3.1.5.1. Projekti Shkolla Verore “Jam shqiptar”

Projekti Shkolla Verore “Jam shqiptar” u zhvillua në Shqipëri për të tretën herë rradhazi, në datat 05-15 korrik 2025, për nxënësit e shkollave shqiptare nga diaspora në Zvicër.

Agjencia Kombëtare e Diasporës me mbështetjen e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme mirëpriti të rinjtë nga diaspora në Zvicër, duke organizuar një program 11 ditor, me shtrirje në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Ky program kishte si qëllim mësimin e gjuhës amtare shqipe ku nxënësve ju ofrua mundësi të studionin dhe të praktikonin gjuhën shqipe, të njiheshin me historinë, natyrën, kulturën, traditat e vendeve të ndryshme të Shqipërisë, si dhe të krijonin dhe konsolidonin miqësi të reja me moshatarët e tyre në Shqipëri. Mbështur në programin të shkollës verore, përveç kryeqytetit, nxënësit vizituan edhe qytete të tjera të Shqipërisë si: Durrës, Krullë, Shkodër, Lezhë, Berat etj, si dhe muzeumet, kështjellat dhe atraksionet e tjera historike dhe kulturore sipas përkatësisë së tyre.


Impakti:

- Mësimi i gjuhës: Nxënësit studiuuan dhe praktikuan gjuhën amtare shqipe.
- Njohja me rrënjët: Të rinjtë u njohën me historinë dhe kulturën shqiptare
- Zbulimi i natyrës: Grupi vizitoi peizazhet dhe traditat vendase.
- Rrjetëzimi: Nxënësit krijuan miqësi të reja me moshatarët e tyre në Shqipëri.

Në përfundim të këtij projekti nxënësit, përmes njohurive të fituara do ti përcjellin dhe tek moshatarët e tyre në Diasporë.

3.1.5.2. Projekti “Turi “ Shqipëria përmes syve të të rinjve arbëreshë”

Projekti “Turi “ Shqipëria përmes syve të të rinjve arbëreshë”, me një grup të rinjsh arbëresh nga komunat arbëreshe Montecilfone, Portocannone dhe Ururi Itali, projekt u zhvillua nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, nën kujdesin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, në datat 18-24 shtator 2025. Sipas programit 7 (shtatë) ditore të këtij projekti, të rinjtë arbëreshë të cilët vizituan qytetin e Tranës por edhe qytete të tjera me atraksione historike e kulturore, u njohën me rrënjët e tyre, fituan njohuri mbi historinë, kulturën dhe traditat shqiptare, krijuan lidhje të forta mes tyre si dhe forcuan më shumë ndjenjën e atdhedashurisë.

3.1.5.3. Projekti “Trajnimi i të rinjve valltarë nga diaspora shqiptare në Zvicër”

Projekti “Trajnimi i të rinjve valltarë nga diaspora shqiptare në Zvicër”, u zhvillua në datat 02-09 nëntor 2025 në Shqipëri. Ky program kishte si qëllim forcimin e lidhjeve të të rinjve nga diaspora shqiptare në Zvicër me vendin e tyre amë, si dhe përvetësimin e njohurive të mëtejshme mbi vallëzimin dhe përparimin e misionit të tyre kulturor në vendet ku ata jetojnë. Trajnimi i të rinjve u realizua nga koreografë profesionistë të Ansambllit Popullor të Këngëve dhe Valleve të Shqipërisë dhe nga valltarë të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit. Me anë të këtij projekti, grupi i të rinjve nga diaspora shqiptare në Zvicër, i zhvilloi më tej aftësitë e tyre përmes vallëzimit duke i përcuar edhe në vendet ku ata jetojnë, për të ruajtur dhe përhapur më gjerë identitetin e tyre kulturor, nëpërmjet veprimtarive kulturore e bashkëpunimeve komunitare.



3.1.5.4. Projekt kulturor: Shfaqja e dokumentarit “Një princeshë evropiane” dedikuar jetës së Donika Kastriotit

Agjencia Kombëtare e Diasporës në bashkëpunim me subjektin "AR Production", gjatë vitit 2025 nisën zbatimin me sukses të projektit kulturor që ka si qëllim promovimin e dokumentarit "Një princeshë evropiane", dedikuar jetës së Donika Kastriotit, pjesë e projektit Përmes Syve të Grave "Histori Shqiptare për Botën".

Ky është një projekt kinematografik i rëndësishëm, i cili trajton jetën dhe veprën e Donika Kastriotit, një nga figurat më të rëndësishme femërore të historisë shqiptare. Projekti përshin disa faza zbatimi, me kohështirje viti 2025-2026.

Dokumentari "Një princeshë evropiane" është realizuar nga regjisori Ylli Pepo, Artist i Merituar, është një realizim i ri kinematografik i cili trajton jetën e Donika Kastriotit dhe përcjell historinë shqiptare nëpërmjet një personaliteti të rëndësishëm femëror. Dokumentari ka marrë vlerësime të larta dhe ndodhet aktualisht në qarkullim në festivale ndërkombëtare. Ky dokumentar ofron një perspektivë të re dhe të fuqishme mbi historinë e Shqipërisë, duke theksuar rolin e grave në formësimin e identitetit kombëtar dhe luftën për mbrojtjen e atdheut.

Në kuadër të këtij projekti, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Greqi, në bashkëpunim me regjisorin e mirënjohur Ylli Pepo, Shoqatën e Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë në Greqi “Liter-Art” dhe Fondacionin Michael Cacoyannis, me mbështetjen e Agjencia Kombëtare e Diasporës, realizoi me sukses shfaqjen e dokumentarit “Një Princeshë Evropiane” në datë 9 dhjetor 2025 në Greqi.

3.1.6. Aktiviteti “Gjon Mili Jazz& Blues Festival” 8 , 9 dhe 10 korrik 2025 në Tiranë

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka bashkëpunuar dhe mbështetur financiarisht edicionin e IV-ët të aktivitetit “Gjon Mili Jazz& Blues Festival”, organizuar nga Organizata “Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim” (RIAS) i cili u zhvillua në datat 8, 9 dhe 10 korrik 2025 në Tiranë.



Agjencia Kombëtare e Diasporës e mbështeti këtë projekt, në bazë të qëllimit të tij në nxitjen e aktivitetit artistik dhe krijimtarinë në muzikën Jazz dhe Blues duke motivuar muzikantët e rinj shqiptarë me anë të shkëmbimit artistiko-kulturor me muzikantë kombëtarë dhe ndërkombëtarë me eksperiencë, dhe promovimin e talenteve të reja ku gjatë këtij viti kishte edhe muzikantë shqiptarë të diasporës.

Gjithashtu, ky aktivitet synoi ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe promovimin e figurës historike të Gjon Milit (artisti shqiptar i cili jetoi dhe punoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës), si e vetmja urë lidhëse që kombi shqiptar ka me historinë botërore të muzikës Jazz dhe Blues si dhe tregimin e kontributit të Gjon Milit në muzikën jazz në vitet '40'.

3.1.7. Projekt në kuadër të ditës së Alfabetit

Në datë 22 nëntor 2025, në kuadër të Ditës së Alfabetit, Agjencia Kombëtare e Diasporës realizoi një video promovuese me nxënës dhe mësues në diasporë.

Qëllimi i saj, ishte nderimi i një prej momenteve më të rëndësishme të historisë sonë, krijimi i Alfabetit të Gjuhës Shqipe, duke nënvizuar rëndësinë e ruajtjes dhe përhapjes së gjuhës sonë amtare për brezat e rinj në diasporë.

3.1.8. Bashkëpunim në kuadër të CulturAlb – Ditët Shqiptare në Botë – Athinë në datat 14 – 17 nëntor 2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka qenë e pranishme në takimet e zhvilluara në kuadër të “Javës Kulturore” në Athinë në datat 14-17 nëntor 2025. Agjencia u përfaqësua nga Drejtori Ekzekutiv znj. Ermonela Xhafa.

3.1.8.1. Aktivitet me Shoqatën “Tirona – Lidhja e Shqiptarëve në Greqi”

Në Athinë u zhvillua një aktivitet i veçantë organizuar nga Shoqata “Tirona – Lidhja e Shqiptarëve në Greqi”, një nga organizatat aktive të komunitetit shqiptar në Greqi në përkujtimin e një date të shënuar, 17 nëntorit, 81-vjetorin e Çlirimit të Tiranës.

Në këtë aktivitet mori pjesë Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Ermonela Xhafa, e cila në fjalën e saj përshëndetëse përcolli urimet më



të përzemërta për këtë ditë të shënuar, duke vlerësuar kontributin e çmuar të paraardhësve tanë në çlirimin e Tiranës, por dhe gjithë Shqipërisë. Znj. Xhafa shprehu konsiderata për shoqatën Tirona, si dhe çdo shoqatë në Greqi dhe diasporë për rolin e tyre të spikatur në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit shqiptar. Znj. Xhafa nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit institucional ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi dhe mësuesve dhe shoqatave shqiptare, duke veçuar hapat e ndjekura deri më tani për mundësinë e hapjes së Qendrës Kulturore Shqiptare në Greqi, si një hap i rëndësishëm për promovimin e gjuhës dhe kulturës sonë kombëtare.

Në aktivitet ishin të pranishëm:

Z. Pavlos Kristidhis, deputet i PASOK-ut, Kryetar i komisionit Parlamentar për Kontrollin e Refugjatëve, Imigracionit dhe të Drejtave të Njeriut;

Z. Panajotis Halafis, Zv. Kryetar i Bashkisë së Athinës,

Znj. Silvana Leskaj, Drejtore e DEKD në MEPJ,

Znj. Joneda Doda, përfaqësuese e Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Greqi,

Znj. Lindita Kulla, Kryetare e Shoqatës “Tirona” në Greqi,

Z. Anastas Murati, aktivist i mirënjohur i komunitetit shqiptar në Greqi.

Gjithashtu morën pjesë dhe përfaqësues të Radio Televizionit Shqiptar, përmes gazetarit të RTSH3 z. Artur Bejzade, kanalit të dedikuar për diasporën shqiptare, i cili solli përjetime interesante të kësaj dite plot emocione, kulturë dhe krenari kombëtare.

Të pranishëm ishin mësues të shkollave shqipe, nxënës dhe bashkatdhetarë, të cilët me pjesëmarrjen e tyre e bënë këtë ditë edhe më të ngrohtë dhe kuptimplotë.

Në këtë atmosferë festive u nderua me respekt dhe mirënjohje 17 nëntori, Çlirimi i Tiranës, si një kujtesë e gjallë e sakrificave dhe e idealit për liri, dinjitet e bashkim kombëtar, vlera që vazhdojnë të udhëheqin shqiptarët kudo në botë.



3.1.8.2. Takime me shoqatat shqiptare në Athinë

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Diplomacisë Ekonomike, Kulturës dhe Diasporës (MEPJ), si edhe me Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Greqi, zhvilluan një sërë takimesh të frytshme me përfaqësues të shoqatave shqiptare në Athinë. Në takim mori pjesë edhe anëtari i Këshillit Koordinues të Diasporës, përfaqësues për Greqinë, z. Ermal Sulaj.

Këto takime synuan forcimin e bashkëpunimit institucional, dëgjimin nga afër të nevojave dhe propozimeve të komunitetit, si dhe identifikimin e mundësive të reja për projekte ekonomike, kulturore dhe sociale që lidhen me diasporën tonë aktive dhe të përkushtuar.

Gjatë diskutimeve u nënvizua roli jetik i diasporës në zhvillimin e vendit, ruajtjen e identitetit kombëtar dhe promovimin e vlerave shqiptare në Greqi. Përfaqësuesit e shoqatave ndanë përvojat, sfidat e përditshme dhe idetë për nisma të reja që mund të sjellin bashkëpunim edhe më të ngushtë.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) e ka në fokus diasporën, duke forcuar lidhjet me çdo shqiptar kudo në botë, për të ruajtur unitetin kombëtar, për të promovuar kulturën dhe vlerat tona, si edhe për të afirmuar në mënyrë të qëndrueshme rolin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

3.1.8.3. Bashkëpunim në kuadër të CulturAlb – Ditët Shqiptare në Botë – Poloni datë 25 nëntor – 5 dhjetor 2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës, në kuadër të projektit “CulturAlb-Ditët Shqiptare në Botë”, u bë pjesë e javës kulturore shqiptare që u zhvillua në Poloni, gjatë intervalit kohor 25 nëntor- 5 dhjetor 2025.

Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, znj. Ermonela Xhafa dhe Drejtoresha e DEKD në MEPJ, znj. Silvana Leskaj, më 2 dhe 3 dhjetor 2025 në Varshavë zhvilluan takime të rëndësishme lidhur me diasporën, në kuadër të javës



“CulturAlb – Ditët e Shqiptarëve në Diasporë”, të organizuara nga MEPJ, MTKS dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Në datën 2 dhjetor 2025 u zhvillua takimi me përfaqësues të diasporës tonë të mrekullueshme në Poloni, një komunitet intelektual, i gjallë e plot ide që na frymëzojnë.

Takimi u organizua me kujdesin e Ambasadores së RSH në Poloni, znj Mimoza Halimi si një dialog i drejtpërdrejtë, i sinqertë dhe i frytshëm mbi nevojat dhe pritshmëritë e diasporës shqiptare në Poloni. Momente inspiruese, kritika të qenësishme, por me energji pozitive dhe hapa konkretë drejt forcimit të urave profesionale, kulturore dhe njerëzore me atdheun.

Znj. Leskaj zhvilloi një takim me z. Maciej Falkowski, zv. Drejtor i Departamentit për Tregti dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë për të diskutuar organizimin e Sesionit të 8-të të JEC dhe përparimin e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar ndërmjet Shqipërisë dhe Polonisë. Paralel me Komisionin do të punohet edhe për organizimin e një forumi biznesi. U propozua gjithashtu dhe ngritja e një mekanizmi të përbashkët për promovimin e eksporteve shqiptare dhe u dakordësuan hapat për finalizimin e marrëveshjeve të hapura.

Në datën 3 dhjetor u zhvillua edhe një takim zyrtar me z. Rafał Perl, Zëvendës Drejtor i Drejtorisë së Diasporës, në ambientet e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Varshavë.

U vlerësua mbështetja që Polonia i ka dhënë Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Evropian, bashkëpunimi në fushën e turizmit, ku një kontribut të madh kanë dhënë turistët polak në turizmin shqiptar dhe promovimin e tij, lidhjet direkte të fluturimeve mes Polonisë dhe Shqipërisë. U diskutua mbi mundësi të reja bashkëpunimi, projektet e së ardhmes dhe mënyrat se si mund të thellohet bashkëpunimi institucional për mbështetjen e komunitetit tonë në Poloni.

Në mbyllje të aktiviteteve të zhvilluara gjatë Ditëve Shqiptare në Diasporë, u organizua një takim shumë i vlefshëm me të rinjtë dhe familjet shqiptare që jetojnë, punojnë dhe



studiojnë në Krakow. Ky grup, i vogël në numër, por i madh në vlerat që përfaqëson, është krijuar përgjatë dhjetë viteve të fundit dhe përbëhet nga shqiptarë që punojnë në organizma ndërkombëtarë, si dhe nga studentë që shkëlqejnë në universitetet prestigjioze të Krakovit. Prania dhe arritjet e tyre janë një pasqyrë e denjë e identitetit dhe kulturës sonë.

3.1.9. Forumi i Ekspertëve Rajonalë të Diasporës në Prishtinë, datë 12 dhjetor 2025

Agjencia Kombëtare e Diasporës u bë pjesë e Forumit Regional Diaspora Expert's, përmes pjesëmarrjes virtuale në datën 12.12.2025.

Forum i Ekspertëve Rajonalë të Diasporës i mbajtur në Prishtinë, bashkoi autoritetet shtetërore, profesionistët e diasporës, shoqërinë civile dhe ekspertët akademikë nga Ballkani Perëndimor. Gjatë këtij forumi, përmes diskutimeve, paneleve dhe rasteve studimore, pjesëmarrësit identifikuan mënyra për të forcuar bashkëpunimin midis diasporës dhe institucioneve për një ndikim të qëndrueshëm rajonal.

Drejtoresha Ekzekutive znj.Xhafa zhvilloi një prezantim mbi rolin e Agjencisë dhe lidhjen me integrimin europian si dhe kontributet në kuadrin ligjor, strategji dhe politika.

3.1.10. Kuvendi III – i Arbëreshëve

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka qenë e pranishme në Kuvendin e Tretë të Studimeve Arbëreshe zhvilluar në datë 30 tetor 2025, në mjediset e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Tiranë nën organizimin e Qendrës e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA).

Kuvendi i Tretë i Studimeve Arbëreshe u zhvillua në tematikën “Narrativa të së shkuarës dhe së tashmes në dialektikën diasporë–vendi amë: Arbëreshët dhe Shqipëria”.

Kjo çështje me një rëndësi të qenësishme për kombëtarinë, u diskutua për herë të parë në qarqet akademike shqiptare, në një trajtim i cili mëton të hedhë dritë përmes



interpretimesh shkencore të shkollave të reja të mendimit mbi këtë raport të vendit amë, Shqipërisë, me komunitetin arbëresh, mbi dialektikën dhe dimensionet komplekse të diasporës dhe vendit të origjinës.

Kuvendi mbledhi bashkë akademikë shqiptarë e arbëreshë, personalitete nga bota arbëreshe, përfaqësues nga ambasada e Republikës së Italisë në Tiranë, përfaqësues nga institucionet shtetërore, përfaqësues nga politika, media, arti etj. Aktiviteti u pasyrua në mediat kombëtare.

4. DATABAZA E STUDENTËVE

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 504, datë 24.06.2020, për "Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë", është ngritur një sistem i brendshëm i databazës, i cili është produkt i Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Ky projekt ka si objekt grumbullimin dhe përditësimin e të dhënave për studentët dhe shtetasit e huaj që përfitojnë bursa studimi nga shteti shqiptar.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 504, datë 24.06.2020, dhënës të informacionit për bazën e të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, janë Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe Ministria përgjegjëse për Punët e Jashtme.

Projekti u përfundua në muajin prill 2025, me krijimin dhe vënien në funksion të bazës së të dhënave shtetërore për studentët që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasit e huaj me origjinë shqiptare që përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë.

5. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Gjatë vitit 2025 është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

- Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Shoqatës “Empowered Women of Diaspora”, shoqatë jofitimprurëse me seli në Londër, Mbretëri e Bashkuar, me



qëllim forcimin e identitetit shqiptar, promovimit të diplomacisë kulturore dhe rolit të gruas shqiptare në diasporë.

6. RAPORTIM DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

6.1.ANALIZË FINANCIARE JANAR-DHJETOR 2025

Ky raport financiar përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2025 dhe synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe gjithëpërfshirëse mbi menaxhimin e burimeve financiare të akorduara Agjencisë Kombëtare të Diasporës sipas Ligjit të Buxhetit të vitit 2025, duke vlerësuar nivelin e transparencës, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë institucionale.


Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit të vitit 2025 është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga të Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 06.03.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2019-2025 dhe Planit të Veprimit.

Bazuar në tavanet buxhetore për vitin 2025, shkresën nr. 14395 datë 09.10.2025 “Kërkesë për rishpërndarjen ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente” si dhe në shkresën nr. 18059/104 datë 31.12.2025 “Mbi zbatimin e Aktit Normativ Nr. 11, datë 19.12.2025 për shpenzimet korrente”, Agjencia Kombëtare e Diasporës në fund të vitit 2025, rezulton me një fond buxhetor prej 69,725,852 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, i detajuar si më poshtë:

– Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore)	21,925,852 lekë;
– Shpenzime korrente (mallra dhe shërbime,bursa)	39,700,000 lekë;
– Shpenzime kapitale (investime)	8,000,000 lekë.
– Fond i vecantë	100,000 lekë.

Gjithsej

69,725,852 lekë




6.2.Realizimi

Agjencia Kombëtare e Diasporës, referuar buxhetit të vitit 2025, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në përfundim të vitit buxhetor Janar-Dhjetor 2025, rezulton se shpenzimet faktike janë realizuar si më poshtë:

TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI (PLAN-FAKT)

Llog.ek	Përshkrimi	Buxheti Plan 2025	Buxheti Fakt 2025	Buxheti i realizuar %
600	Shpenzime për Paga	18,900,000.00	16,960,410.00	89,7 %
601	Shpenzime për Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	3,025,852.00	2,537,737.00	83,9 %
602	Shpenzime Korrente	39,700,000.00	29,080,132.00	73,3 %
231	Shpenzime Kapitale	8,000,000.00	-	0%
606	Fond i vecantë	100,000.00	25,334.00	25,3%



6.2.1. Për fondin e pagave dhe sigurimeve (Ilogaria ekonomike 600,601)

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve u realizua deri në 11 punonjës, nga 16 punonjës të miratuar me Urdhrin Nr.111, Datë 10.09.2020 “Për miratimin e Strukturës së Organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës” e përbërë nga Drejtoria e Diasporës (Sektori i Diasporës dhe Sektori i Kulturës, Identitetit dhe Komunikimit), Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Sektori i Projekteve.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 16,960,410 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e katërqind e dhjetë) lekë ose 89.7 % e fondit të planifikuar për vitin 2025 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,537,737 (dy milion e pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë, ose 83.9 %, e planifikimit për periudhën respektive.



6.2.2. Shpenzimet Korrente (mallra dhe shërbime, llogaria ekonomike 602)

Për periudhën Janar - Dhjetor 2025, fondi i shpenzime korrente është realizuar në vlerën 29,080,132 (njëzet e nëntë mijë e tetëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë dy) lekë ose 73.3 % e fondit të planifikuar.

Në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë kësaj periudhe, shpenzimet korrente, bazuar në Programin Vjetor të miratuar kanë konsistuar kryesisht në:

- Shpenzime të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime.
- Shpenzime të përgjithshme administrative.
- Shpenzime për programin e Shkollës Verore “Jam Shqiptar”.
- Shpenzime për programin i vizitës kulturore, të komunitetit arbëresh të Italisë në Shqipërisë.
- Shpenzime në kuadër të ruajtjes së kulturës dhe identitetit kombëtar (trajnim i valltarëve nga Diaspora pranë koreografëve të TOB).
- Shpenzime në kuadër të aktiviteteve në bashkëpunim me Ambasadat e Republikës së Shqipërisë.
- Shpenzime në kuadër të aktiviteteve në bashkëpunim me shoqatat në Diasporë.
- Shpenzime në kuadër të bashkëpunimit me Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare.
- Shpenzime për dokumentarë mbi Diasporën.
- Shpenzime për ridizenjimin e faqes Web të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

6.2.3. Shpenzime kapitale (llogaria ekonomike 231)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 fondi i shpenzimeve kapitale nuk është realizuar.

6.2.4. Fond i veçantë (llogaria ekonomike 606)

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 fondi i veçantë është përdorur për pagesat e shërbimit të komunikimeve elektronike në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673 datë 2.9.2020 “Për pajisjen me Numër Telefoni Celular të Funkionarëve Publikë”.



6.3.DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE (FUNKSIONIMI)

6.3.1. Financa

Gjatë kësaj periudhe sektori i financës ka evidentuar me përpikmëri nëpërmjet kontabilizimeve në ditarët përkatës (ditari i magazinës si dhe shpenzimeve të arkës dhe të bankës) të gjitha shpenzimet e kryera në valutë si edhe në lekë.

Në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar si dhe udhëzimin në zbatim të tij dhe kontrollin, sektori i financës ka përgatitur të gjitha urdhër-shpenzimet në afatin e caktuar për faturat e paraqitura nga kryerja e prokurimeve publike, pagesat për pagat, honoraret dhe dietat e punonjësve. Janë përgatitur dhe likuiduar 170 urdhër shpenzime.

Janë përgatitur brenda afatit të gjitha listë pagesat për pagat si dhe listë pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesat e pagave të punonjësve nëpërmjet listë pagesave dhe urdhër shpenzimeve.

Bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”, në fund të vitit kryhet inventarizimi i aktiveve.

Janë përgatitur raportimet periodike për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, rakordimet me Degën e Thesarit si dhe çdo informacion tjetër me karakter financiar.

6.3.2. Burime Njerëzore

Struktura e re e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është miratur me Urdhërin Nr.111, datë 10.09.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës”.

Marrëdhëniet e punës për Drejtorin Ekzekutiv dhe nëpunësit e Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil. Sipas strukturës së miratuar, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka 16 pozicione pune në total. Gjatë vitit 2025, numri mesatar i punonjësve të emëruar është 11.



Burimet njerëzore janë një faktor i rëndësishëm në realizimin e objektivave kryesorë institucionalë. Në këtë kontekst, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka patur si objektiv prioritar jo vetëm ngritjen e kapaciteteve të brendshme por dhe ruajtjen e një strukture organike që do ti mundësonte eficiencë në realizimin e misionit të saj. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është i orientuar drejt administrimit me korrektësi të dosjeve të personelit, si dhe vlerësimit vjetor të performancës në punë për çdo punonjës, në kohë dhe në përputhje me rregullat administrative përkatëse si dhe identifikimit të nevojave të personelit për përmirësimin e aftësive profesionale të tyre nëpërmjet realizimit të trajnimeve në përshtatje me nevojat profesionale të vendit të punës me qëllim përballimin e sfidave të ndryshme në të ardhmen.

Gjatë vitit 2025, nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Diasporës kanë ndjekur trajnime të ndryshme të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA), Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike (AKSK). Temat e trajnimeve kanë qenë gjithëpërfshirëse, si: "IA në Administratën Publike: Mundësitë dhe Rreziqet", " Menaxhimi i kulturës organizative në AP", "Sistemi elektronik i Prokurimit Publik", "Prokurimi me vlerë të vogël", "Forcimi i kapaciteteve për hartimin dhe zbatimin efektiv të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA)", "Administrata e së ardhmes", "Legjislacioni në fushën e sigurisë kibernetike", "Testimi i aplikacioneve Web. Demo Live", "Maratona Kombëtare e Vajzave dhe Grave në Sigurinë Kibernetike", "Kërkesat dhe Detyrimet për Monitorimin dhe Raportimin e Asistencës Financiare IPA", "E ardhmja e menaxhimit të projekteve: Çertifikimi , digjitalizimi dhe transformimi i profesionit", "Protokolli zyrtar dhe Etiketa e Shtetit", "Trajnim sekretari arkiva", etj.

Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në përputhje me Ligjin "Për nëpunësin civil" dhe aktet nënligjore ka realizuar përgatitjen e dosjeve të personelit, raportimet periodike në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe ka administruar procesin e vlerësimit të performancës në punë për punonjësit e institucionit.



Gjatë këtij viti në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ligji “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe nëpunësve publik”, autoriteti përgjegjës ka ndjekur depozitimin në kohë të formularit të Deklarimit të Interesave Privatë Periodik/Vjetor për subjektet që kanë detyrim deklarimi dhe ka realizuar raportimet pranë ILDKPKI-së.

6.3.3. Protokolli

Në bazë të ligjit "Për Arkivat", është bërë pritja e shkresave të hyra në institucionin, duke i vendosur kartelën shoqëruese, numrat e protokollit dhe përcjelljen e tyre drejt drejtuesit të Institucionit, i cili bën shpërndarjen e shkresave sipas drejtorive përkatëse. Është kryer procedura ligjore për shkresat dalëse të institucionit tonë, duke verifikuar fillimisht plotësimin e kushteve dhe parametrave që përcakton ligji ynë në pjesën e ndërtimit të shkresave, vendosjen e numrit të protokollit, dërgimit të tyre drejt drejtuesit të Institucionit për firmosje dhe vulosje dhe së fundmi klasifikimin e dokumenteve sipas strukturave organizative të institucionit.

6.3.4. Magazina

Në hyrjen dhe shpërndarjen e artikujve nga magazina është ndjekur procedura ligjore duke bërë evidentimet e nevojshme në fletë-hyrjet, fletë-daljet dhe janë bërë pasqyrimet në Librin e Magazinës për sasi të artikujve të dala nga magazina dhe gjendjen e tyre të mbetur në magazinë.

Në fund të vitit është kryer inventarizimi i aktiveve bazuar në Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve”.

6.3.5. Prokurime

Në zbatim të planit vjetor të shpenzimeve, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka hartuar e zbatuar regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik për vitin 2025, i cili është realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit me vlerë të vogël dhe blerjeve nën 100.000 lekë pa tvsh.

Në mbështetje të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar, VKM nr. 285/2020 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar dhe



udhëzimeve përkatëse në fuqi për periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë kryer dhe realizuar me sukses procedurat e prokurimit publik me objekt të ndryshëm prokurimi duke përfshirë “Blerje bileta transportit ajror ndërkombëtar”, “Ridizenjim i faqes web të Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, “Blerje bojra printeri”, “Blerje materiale kancelarie”, “Blerje produkte promovionale”, “Shërbim mirëmbajtje dhe riparimi të printerave dhe fotokopjeve”, etj.

Në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) janë krijuar gjithsej 20 elementë në regjistrin e parashikimeve për vitin 2025. Nga këto janë realizuar 11 elementë nën vlerën 100,000 lekë dhe 3 elementë (10 procedura prokurimi me vlerë të vogël) deri në vlerën 1.000.000 lekë.

SFIDA NË TË ARDHMEN

PROGRAMI 2026

Programi 2026 është hartuar duke mbajtur në vëmendje angazhimin e diasporës dhe përfshirjen në jetën politike, sociale, ekonomike të vendit të origjinës. Fokusi do të jenë afrimi i të rinjve me Shqipërinë dhe transmetimi.

OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN NËPËRMJET PROGRAMIT

1. Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me diasporën;
2. Ndërgjegjësimi dhe lehtësimi i përfshirjes së diasporës në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të vendit;
3. Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me komunitetet shqiptare në botë;
4. Nxitja e bashkëpunimit ekonomik nëpërmjet investimeve nga diaspora;
5. Ruajtja e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare si dhe zhvillimi i identitetit të pjesëtarëve të diasporës
6. Pasurimi i bazës së të dhënave të diasporës shqiptare;
7. Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
8. Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.



TARGET GRUPET

1. Komunitetet e hershme dhe të reja shqiptare në Diasporë;
2. Rrjetëzimi i profesionistëve në diasporë
3. Shoqatat, organizatat, grupet lokale dhe rrjetet e krijuara nga diaspora shqiptare;
4. Të rinjtë në diasporë.

IMPAKTI

Nisur nga nevoja e diktuar për angazhimin e diasporës në vendlindje si një mënyrë e re veprimi në zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të Shqipërisë dhe krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për kontributin e tyre, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka planifikuar programin vjetor të aktiviteteve i cili do të ndikojë jetën ekonomike, sociale, politike, kulturore të vendit nëpërmjet angazhimit të diasporës.

Programi përcakton një vizion të qartë, prioritetet dhe mënyrën për t'u lidhur dhe angazhuar me diasporën në zhvillimin e vendlindjes duke përdorur një qasje fleksibël zbatimi dhe partneriteti, duke iu referuar gjithashtu angazhimit të përgjithshëm politik të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

PRITSHMËRITË

1. Krijimi dhe forcimi i lidhjeve të forta emocionale, ekonomike, sociale dhe kulturore me komunitetet shqiptare në botë;
2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngjalljes së ndjenjës së atdhedashurisë për vendin e origjinës;
3. Nisma të iniciuara nga bizneset e diasporës për investime në vendin amë;
4. Pasurimi i bazës së të dhënave me pjesëtarë të rinj nga diaspora e të gjithë target grupeve.
5. Evidentimi i problematikave me të cilat përballlet diaspora dhe referimi për trajtim në strukturat përkatëse;
6. Forcimi i besimit ndaj institucioneve të vendlindjes;
7. Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë.



METODOLOGJIA

Organizimi i vizitave në Shqipëri, me grupe të rinjsh nga komunitetet shqiptare në diasporë, nëpërmjet programeve që synojnë njohjen e tyre me Shqipërinë: gjuhën, traditat, kulturën e historinë. Vizitat do t'iu japin mundësi të rinjve të thellohen më shumë në gjuhën shqipe dhe traditat kulturore.

Organizimi i konferencave apo tryezave të rumbullakëta, me qëllim trajtimin dhe diskutimin e tematikave të rëndësishme që lidhen me diasporën, me pjesëmarrjen e aktorëve me role kyçe.

Mirëmbajtja dhe pasurimi i bazës së të dhënave, përmes mbledhjes sistematike, gjithëpërfshirëse dhe hartëzimin e diasporës, si dhe përfshirjen e një game të gjerë të anëtarëve të diasporës, në praktika konsultimi, nëpërmjet së cilës do të arrihet të kuptohet se çfarë ofron diaspora, çfarë është e gatshme të ofrojë, dhe çfarë pritet në këmbim nga qeveria.

Anëtarët e Diasporës në mbarë botën, konsiderohen si forcë lëvizëse dhe potenciali i tyre, mund të dalë në pah, vetëm nëse ekzistojnë mekanizma të përshtatshëm angazhimi dhe nëse organizatat dhe organet e tyre përfaqësuese, fuqizohen për t'u bërë pjesë e një marrëdhënieje të besueshme, ndërmjet diasporës, institucioneve dhe publikut të gjerë në vend.

Bashkëveprimi i ngushtë me përfaqësitë diplomatike në vendet ku ka një numër të konsiderueshëm të diasporës sonë, me organizatat dhe shoqatat e diasporës, të cilat përfaqësojnë zërin e anëtarëve të diasporës në vendet pritëse, mund të luajnë një rol të rëndësishëm, në proceset strategjike vendimmarrëse në Shqipëri, si dhe mund të nxisin nisma të çmuara për bashkëveprimin shoqëror, ekonomik dhe intelektual ndërmjet diasporës dhe Shqipërisë.



**AGJENCIA
KOMBËTARE
E DIASPORËS**

PËRMBYLLJE

Raporti i vitit 2025 është dokumenti gjithëpërfshirës i punës dhe veprimtarisë vjetore të Agjencisë Kombëtare të Diasporës. Përfundimi i këtij viti, nuk mund të ishte i tillë pa angazhimin e çmueshëm të stafit të Agjencisë, partneritetin e të gjithë aktorëve publik dhe privat, vendas e ndërkombëtar.